



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:299678
Datë: 02.08.2024
Numri i dokumentit: 06012980

P.nr.570/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE MITROVICE, DEGA NË VUSHTRRI-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arta Jusufi në çështjen penale kundër të pandehurit R.H nga fshati ... komuna e Obiliqit, te cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av. Leart Muli për shkak të veprës penale Shmangja nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore nga neni 312 par.5 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 4089/19 të datës 01.09.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik të datë 15.07.2024, në praninë e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij në të njëjtën datë, mori dhe shpalli kurse me dt. 02.08.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: R.H , nga i ati S..., e ëma M..., e vajzërisë P..., i lindur me ... ne fshatin ..., me vendbanim ne fshatin ..., komuna Obiliq, nr. personal ..., me profesion bujk, ka te kryer shkollën e mesme teknike, baba i 3 fëmijëve, i pa pune, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE: Më me dt.26.12.2019 edhe pse ishte në gjendje të kuptonte rëndësinë e veprës se tij dhe të drejtoj me veprimet e tij, dhe ekzekutimin e tij, i vetëdijshëm për ndalimin e veprës nga personi i panjohur ka marre cigare nga personi i panjohur tipit "Bond" te prodhuara ne Republikën e Serbisë pa pulla te përshkruara fiskale te kontrolluara te Republikës se Kosovës dhe atë me se paku 68 paketime ne te cilat ne secilën nga 50 paku saktësisht 3.400 paku cigare tipit "Bond" te cilat transportonte me automjetin tipit "Peugeot Boxer" me targa Gjermane ... dhe kur doganieret e Kosovës urdhëruan për tu ndale atë nuk e beri por përshpejtoi lëvizjen e automjetit, me ç ‘rast zyrtaret e doganës me automjet u dhanë ne ndjekje te se njëjtit , kur e kapen ne fshatin ... , komuna e Vushtrrisë afër kishës ortodokse , me ç ‘rast i njëjti doli nga automjeti dhe tentoi te largohet por u pengua dhe u ndalua nga ana e doganës se Kosovës. prandaj, ai transportoi produkte akcize — cigare te cilat nuk kane pas pullat fiskale duke shmangur pagesën e akcizave ne shume prej 31960€ (tridhjetenjëmijënëntëqindëgjashhtëdhjetë euro) .

- Më këtë ka kryer veprën penale Shmangja nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore nga neni 312 par.5 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17, 21, 42, 43, 44, 69, 70 dhe nenit 312 par.5 lidhur me par. 1 të KPRK-se, si dhe në bazë të nenit 364, 452 dhe 462 të KPP-së të pandehurit i shqipton:

DENIM ME GJOBË

Me të cilin gjykata i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 3000€ (tremijë euro), dhe kumulativisht,

DENIM ME BURG

Me të cilin të pandehurit gjykata i shqipton dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj.

Me pëlqimin e të pandehurit e në vështrim të dispozitave të nenit 44 denimi me burgim i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 1800€ (njëmijetëqind euro).

Në vështrim të dispozitave të nenit 76 të KPRK-së të pandehurit gjykata i shqipton:

DENIM UNIK ME GJOBË

Me të cilin të pandehurit gjykata i shqipton dënimin unik me gjobë në shumë prej 4800€ (katërmijetëqind euro), të cilin dënim është i obliguar që t'a paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi. Po që se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 43 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi, duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burgim.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj: në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 30€ (tridhjetë euro), në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumen prej 20€ (njëzet euro).

Mallrat të cilat nuk janë deklaruar, 3400 (tremijekatërqind) pako cigare, konfiskohen (neni 312 par 6 i KPRK-së).

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr. 4089/19 të datës 01.09.2020, kundër te pandehurit R.H , me vendbanim ne ... komuna e Obiliqit, për shkak te veprës penale Shmangja nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore nga neni 312 par.5 te KPRK-se.

Gjykata me date 15.07.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ne këtë çështje penale.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit fillestar

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 12.07.2024, pasi që gjyqtari i vetëm gjykues e ka njoftuar të pandehurin me të drejtat e tij në këtë çështje penale dhe pasi që është bindur se i pandehuri i ka kuptuar udhëzimet e gjykatës, i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë ku i pandehuri pas konsultimeve te mjaftueshme me mbrojtësin ka deklaruar se pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës dhe ka shtuar se jam penduar shumë për atë çka kam vepruar dhe i kërkoj falje gjykatës, zotohem se në ardhmen do të jem më i kujdesshëm që të mos shkel ligjin. Po ashtu ka shtuar se në atë periudhë gjendjen ekonomike e ka pasur të rënduar dhe është dashur që të bëjë përpjekje që të sigurojë jetesën për vete dhe për fëmijët.

Pas pranimit te fajësisë, gjyqtari i vetëm gjykues edhe njëherë e ka njoftuar te pandehurin me favoret dhe disfavoret e pranimit te fajësisë dhe me dispozitat e KPRK-se, por edhe pas kësaj i pandehuri ka deklaruar se dëshiron ta pranoje fajësinë ne mënyrë vullnetare.

Prokurori i Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë se te pandehurit ka deklaruar se deklarimi mbi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është në përputhje dispozitat e KPRK-së për institutin e pranimit të fajësisë, i njëjti mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, dhe është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, andaj nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë, i propozojmë gjykatës që pranimin e fajësisë ta aprovojë. Tutje prokurori i shtetit ka propozuar se nëse gjykata e aprovon pranimin e fajësisë, gjykata të pandehurin ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë sipas ligjit, ndërsa gjatë matjes së dënimit, përcaktimit të llojit dhe lartësisë së tij të merr parasysh rrethanat lehtësues edhe renduese, ashtu që si rrethana lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, ndërsa si rrethana rënduese gjykata të merr parasysh shkallen e lartë të dashjen së drejtim të kryerjes së veprës penale, po ashtu prokurori i shtetit propozon gjykatës që sipas detyrës zyrtare të pajiset me certifikatë nga evidenca penale dhe nëse nga ajo rezulton se i pandehuri është i dënuar edhe më parë ta merr si rrethanë rënduese dhe e kundërta nëse nuk është dënuar më parë, ta merr parasysh si rrethanë lehtësuese. Prokurori i shtetit ka qëndruar po ashtu sipas propozimit si në pikën III të aktakuzës lidhur me konfiskimin e sendeve, siç është përshkruar në aktakuzë.

Mbrojtësi i të pandehurit av. Leart Muli ka deklaruar se Pranimin e fajësisë nuk e kundërshtojë, pasi klienti im i kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, është një moment favorizues për klientin tim me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, andaj gjykatës i propozojë që të mbrojturit tim ti shqiptojë një dënim sa më të butë.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Gjykata, duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë është në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së, kjo pasi që i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit.

Provat e vlerësuara nga gjykata

Gjykata pranimin e fajësisë nga i pandehuri e ka vlerësuar në kuptim të dispozitave të nenit 242 të KPP-se, dhe ka konkluduar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarinë mbi fajësinë nga i pandehuri sepse ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës dhe atë: procesverbali mbi marrjen në pyetje të të pandehurit në prokurori dt. 16.07.2020; Listën e distribuimit të Doganes dt. 26.12.2019; një CD; procesverbalin mbi kundërvajtjen administrative dt. 27.12.2019; procesverbalin mbi marrjen në pyetje të të dyshuarit dt. 26.12.2019; vërtetimi mbi konfiskimin e mallrave dt. 26.12.2019; mendimi për përcaktimin e vlerës dt. 27.12.2019; si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri me dashje ka kryer veprën penale Shmangja nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore nga neni 312 par.5 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 312 par.1 të KPRK –së është parashikuar se formën themelore të veprës penale Shmangja nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore nga neni 312 par.1 e kryen: “ Kushdo që me qëllim që vetes apo personit tjetër t’i mundësojë shmangien nga pagesa e tarifave tatimore doganore apo tarifave tjera ose detyrimeve doganore që paguhen me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave, i paraqet doganës dokument të rrejshëm lidhur me prejardhjen, vlerën, sasinë, cilësinë, llojin apo karakteristikat tjera të mallit ose nuk i paraqet doganës mallrat kur kërkohet nga Kodi Doganor dhe i Akcizave në Kosovë, kur shuma e detyrimeve doganore tejkalon pesë mijë (5000) Euro, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër (4) vjet.”, ndërsa paragrafi 5 i këtij neni me të cilin ngarkohet i pandehuri R.H si forme e kualifikuar e kësaj vepre penale përcakton se “Kushdo që me qëllim që vetes apo personit tjetër t’i mundësojë shmangien nga pagesa e tarifave të akcizave, ofron për shitje, ose përndryshe

posedon, importon, eksporton apo transporton produkte akcizore, produkte pa-pullë fiskale ose banderol apo merret me produkte që nuk kanë pullë fiskale ose banderol, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm në lidhje me akcizën, dënohet me gjobë deri në pesë herë të shumës së akcizës të paevidentuar apo të papapaguar dhe burgim deri në tre (3) vjet. Nëse shuma e akcizës kalon shumë prej njëzet e pesë mijë (25.000) euro, kryesi dënohet me gjobë deri në pesë herë të shumës së akcizës të paevidentuar apo të pa-papaguar dhe burgim deri në pesë (5) vjet.”, elemente këto të figurës së kësaj vepre penale që janë përmbushur tërësisht në këtë çështje penale.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat dhe faktin se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është në përputhje me të gjitha provat në shkresat e lëndës, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpallë fajtor për kryerjen e veprës penale Shmangja nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore nga neni 312 par 5 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Kodi Penal i Republikës së Kosovës për veprën penale Shmangja nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore nga neni 312 par 5 të KPRK-së, ka paraparë dënimin me gjobë deri në pesë herë të shumës së akcizës të paevidentuar apo të pa-papaguar dhe burgim deri në pesë (5) vjet.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 38, 69, dhe 70 të KPRK-së, gjykata ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë nga i pandehuri, keqardhjen e shprehur nga ana e të pandehurit, kërkim faljen e të pandehurit, pastaj rrethanat personale të të pandehurit, përkatësisht faktin se i njëjti është prind i tre fëmijëve, si dhe faktin se i pandehuri, sipas evidencës së kësaj gjykate, nuk evidentohet si kryes i ndonjë vepre tjetër penale. Kurse sa iu përket rrethanave renduese gjykata mori parasysh shkallen e lartë dashjes nga i pandehuri (neni 70 par 2 pika 2.2), shkallën e përgjegjësisë penale si dhe intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me konfiskimin, shpenzimet e procedurës, kërkesën pasurore juridike dhe kompensimin e viktimave të krimit

Vendimin lidhur me konfiskimin e mallrave gjykata e morri në bazë të nenit 312 par. 6 të KPRK-së.

Vendimin lidhur me kërkesën pasurore – juridike, gjykata e morri në bazë të nenit 460 të KPPK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e mori në bazë të nenit 449 dhe nenit 453 par.1 të KPP-së, ndërsa vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e mori në bazë të nenit 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga të lartcekurat e bazuar në nenin 364 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr. 570/20, datë 02.08.2024

Zyrtarja ligjore
Arta Jusufi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ferki Xhaferi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.